



REPUBLIKA E KOSOVËS
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK
Dop. DPK
Nr. Prot. 03-02/4088/17
Prot. No. 03-02/4088/17
Date 13-12-2017
Datum 13-12-2017

Nr. 02



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2442/17, për z. Agron Bytyqi, U.D. Drejtor në Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale të Qendres Klinike dhe Universitare të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë z. Agron Bytyqi, U.D. Drejtor në Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale të Qendres Klinike dhe Universitare të Kosovës dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.T.Sh "Ada Dent" është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Bytyqi është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtari i lartë nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë është deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmerr veprime për shmangien e gjendjes së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/3754/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni person i autorizuar në biznesin privat të cekur më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

